

CAT MAGAZINE

NJË UDHËTIM PREJ 2,000-MILJESH NË ANTARKTIDË
**PËRGATITJA E DY D6N DHE
INXHINIERËT FINNING**

RREGULLAT E MARRJES ME QERA PAJISJE
NË MINËN OYU TOLGOI NË MONGOLI

NË JORDANI, GRUPI JALLAD BËN THIRRJE QË NJË
SISTEM HIBRID TË FUQIZOJ NJË KULLË CELULARE

Teknoxgroup

CAT



FUQIA E TË BËRIT MË SHUMË

KATËR ESKAVATORË HIDRAULIKË TË RINJ TË SERISË E REALIZOJNË NJË ZHVILLIM MË TË SHPEJTË TË CIKLIT DUKE KURSYER LËNDËN DJEGËSE

Eskavatorët e rinj hidraulikë Cat® 324E, 329E, 336E dhe 349E karakterizohen nga motora më të fuqishëm për produktivitet më të lartë ndërkohë që përputhen me standardet e mbetjeve STAGE IIIB. Për ilustrim, motori C9.3 ACERT Cat në modelin 336E ndikon në shtimin e fuqisë prej 12 përqind ndërkohë që përmirëson efikasitetin e lëndës djegëse me 2 përqind. Presion më i madh hidraulik i ushtruar në mënyrën e ngarkimit të peshave të rënda rrit kapacitetin e ngritjes, duke kontribuar në rritjen e rezultateve të punës gjatë ngritjes së peshave të rënda.

PËRMIRËSIMI I EFIKASITET TË LËNDËVE DJEGËSE VJEN SI STANDARD

Kursimi i lëndës djegëse është një shenjë dalluese e modeleve të reja të Serisë E. Një valvulë elektrike rigjenerimi kap dhe rigjeron energji kur bumi është ulur. Një sistem i ri kontrollues i mbylljes së motorit i mundëson pronarëve dhe operatorëve të specifikojnë kohën që i duhet makinës përpara se të fiket motori. Në vijim të kësaj, operatori mund të zvogëlojë shpejtësinë e motorit deri në gjendje jo-punë vetëm me një shtypje të butonit që ndihmon në kursimin e lëndës djegëse.

Për të ruajtur produktivitet të lartë, sistemi i rigjenerimit të pushimit pas-përdorimit garanton funksionimin normal të makinës pa patur nevojën e ndërhyrjes së një operatori. Gjatë operimit të mënyrës automatike të funksionimit, makina nis procesin e rigjenerimit pasi sistemi i filtrimit arrin nje nivel të paracaktuar dhe kushtet janë optimale. Mënyra e operimit manual mundëson që operatori të kontrollojë mënyrën e operimit automatik.

KOVAT CAT TË BREZIT TË RI

Modelet e reja mund të pajisen me një prej kovave të Cat Brezi i Ri për produktivitet optimal. Kovat e reja karakterizohen prej një gjeometrie të zhvilluar që promovon mbushjen efikase për germim të shpejtë dhe zvogëlim të ciklit të herëve. Mbulimi më i madh i veshjes ndikon në rritjen e qëndrueshmërisë, dhe një imazh i ri i ndikon në rritjen e lehtësisë së përputhshmërisë së prangave-hallka.

KONTROLL I LARTË ME KOSTO MË TË ULTA

Sistemi opsional i Kontrollit të Gradimit të Thellësisë dhe Pjerrësisë së Cat ndikon në përmirësimin e produktivitetit dhe uljen e kostove. Sistemi kombinon kontrollin dhe drejtimin e makinave tradicionale me komponentë standardë, të instaluar në magazinë dhe të kalibruar. Përdor sensorët e lidhjes ballore të brendshme për tu dhënë operatorëve informacion të shpejtë rreth këshillave për pozicionin e kovave, duke minimizuar nevojën për kontrollin tradicional të gradimit, duke shtuar sigurinë në frontin e punës, dhe duke ndihmuar operatorët të përfundojnë punë në më pak cikle.

SIGURIA DHE EFIKASITETI TË KOMBINUARA

Siguria e kabinës shtohet prej Strukturës Rrokulluese Mbrojtëse. Gjithashtu, kabinat janë të mbyllura dhe të izoluar ndaj zërit, duke zvogëluar lodhjen e operatorit dhe duke mundësuar kryerjen e punë më produktive. Një monitor me rezolucion të shtuar në kabinë është 40 përqind më i madh. Duke patur butona për përdorim të shpejtë, mund të shfaq deri në 2 imazhe kamere. Një kamera për pamjen e pasme është standarde.

Për të më tepër rehati, lartësia e levës komanduese përshtatet. Një ulëse me opsion ajër të freskët përmirëson rehatinë e operatorit dhe një kompresor me ajër të kondicionuar shton ftohjen e kabinës.

MODELE TË REJA PË SHËRBIM MË TË LEHTË

Për mirëmbajtje më të thjeshtë, eskavatorët hidraulikë të Serisë E përdorin një paketë ftohëse që qëndron krahpërkrah, lehtësisht të arritshme prej dyerve të mëdha dhe të forta. Vaji opsional i motorit dhe kullimi i vajit hidraulik lehtëson shërbimet që kujdesen për mbrojtjen e ambjentit dhe sistemi i rishikuar i ajrit të kondicionuar është lehtësisht i menaxhueshëm. ■

Në një nga minierat më të mëdha në botë të arit dhe bakrit, pajisjet me qira të Cat ndihmojnë për ndërtimin e infrastrukturës së zgjeruar.



I dashur lexues,

Në të gjithë botën, klientët e Caterpillar® përballen me shumë sfida, duke përfshirë çdo gjë që nga moti dhe terreni deri tek ekonomia dhe disponueshmëria e pjesëve. Këto sfida na japin rastin që të bëhemi zgjidhësit e problemit me një burim dhe dhënësit e zgjidhjeve.



Ndërsa punojmë për të zgjeruar gamën e klientëve tanë, njerëzit tek Caterpillar vazhdojnë të përdorin metoda novatore dhe krijuese për tu shërbyer klientëve tanë. Kjo përfshin çdo gjë, që prej teknologjisë deri tek mbështetja ballë për ballë dhe fasilitetet për të shkurtuar kohën e livrimit. Një shembull i përsosur është hapja e Qendrës së Distribucionit të Pjesëve në Lindjen e Mesme në Dubai nga fundi i vitit 2012. Me rritjen e shkaktuar nga Lindja e Mesme dhe Afrika, Caterpillar investoi në një qendër të re distribicioni afër klientëve të Lindjes së Mesme dhe të Afrikës Lindore. Fasiliteti i rizgjeron më tej rrjetin e shpërndarjes së pjesëve të Caterpillar dhe rrit livrimin të shërbimit dhe pjesëve për klientët.

Disponueshmëria dhe shpërndarja e pjesëve gjithmonë kanë qenë një fokus strategjik për Caterpillar. Në këtë numër, kjo rëndësi, për tregtarin dhe klientin, shihet qartësisht. Në artikullin e parë, do të lexoni për sfidat me të cilat u përballëm kur livruam pjesë në mes të Shkretëtirës Gobi të Mongolisë. Një artikull tjetër tregon se si tregtari i Cat® ndihmon që makinat e klientit të tij të gurores të funksionojnë dhe të jenë në gjendje pune në Lindjen e Mesme.

Ky numër i parë i vitit 2013 është plot me arritje të tjera të shquara të Cat. Një 320D L luan një rol kryesor në filmin e fundit të James Bond, RËNIA E QIELLIT. Dy D6N po ndihmojnë për kryerjen e një ekspedite në kushte ekstreme në të gjithë Antarktikën. Karburanti i parë i prodhuar ndonjëherë D7E ka sfidën e parë. Dhe, një klienti mund t'i bëhet livrimi i ekskavatorit të 25,000-t Cat me rrota në Gjermani. Akoma më mahnitin të gjitha tregimet e pabesueshme nga e gjithë bota të cilat me krenari mbajnë emrin Cat.

Paolo Fellin, Zëvendës-president i Caterpillar



A do të jetë udhëtimi i ngadaltë prej gjashtë muajsh në Antarktik një shëtitje në park për dy D6N? Zbulojeni.



Caterpillar prodhon ekskavatorin e 25,000-t me rrota.



Grupi Jallad i tregon Orange vlerën e përdorimit të sistemeve hibride për të qenë të blertë.

PROJEKTI MË I MADH I NDËRTIMIT TË MONGOLISË I MBËSHTETUR NGA PAJISJET ME QIRA CAT

Mësoni për projektin madhështor dhe sfidat e ndërtimit të infrastrukturës për minierën Oyu Tolgoi

4

FAZA NJË: NGROHJA PËRPARA UDHËTIMIT MË TË FTOHTË NË TOKË

Është natyra kundër njeriut dhe D6N në Antarktikë

10

PORTOKALLJA [ORANGE] E KLIENTIT TË JORDAN TRACTOR BËHET JESHILE

Zëvendësimi i diezelit me energji hibride kursen 1,800 litra karburant në muaj

14

NJË EVOLUCION PËR DY DEKADA I EKSKAUTORËVE CAT ME RROTA

Pas më shumë se 20 vitesh, Caterpillar prodhon ekskavatorin e 25,000-t me rrota

16

Më sipër është thjesht një shije asaj se çfarë ka ky numër – ju do të gjeni shumë më tepër brenda lajme dhe pikëpamje. Në qoftë se keni ndonjë ide për ndonjë tregim për numrin e ardhshëm, kontaktoni botuesit tanë tek CatMagazine@cat.com

BOTUESI: Ulrike Schwarzen Dahl, Caterpillar S.A.R.L. **KRYEREDAKTORI:** Laetitia Baudrion, Caterpillar S.A.R.L. **KOORDINIMI I TREGTARËVE:** Anneloes de Jong **SHKRUESI KRYESOR:** Trevor Baker **DREJTIMI I ARTIT:** Ron Strik **KONCEPTI DHE REALIZIMI:** Centigrade for Caterpillar S.A.R.L. www.centigrade.com **KONTAKTI I TREGTARIT VENDOR:** info@teknogroup.com

Revista Cat shpërndahet nga tregtarët e Caterpillar në Evropë, Afrikë, Lindjen e Mesme dhe CIS tre herë në vit. Ju lutemi, dërgoni korrespondencën tuaj editoriale tek revista Cat, Caterpillar S.A.R.L. 76, Route de Frontenex, PO box 6000, 1211 Gjenevë, 6, Zvicër. Catmagazine@cat.com. Të gjitha të drejtat e rezervuara. ©2011 Caterpillar.

PROJEKTI MË I MADH I NDËRTIMIT TË MONGOLISË I MBËSHTETUR NGA PAJISJET ME QIRA CAT

1987-1989

Rilevimet e para gjeologjike

1990

Informacioni gjeologjik bëhet publik, i cili u intereson shoqërive perëndimore

1997

Licenca fillestare e eksplorimit i jepet Shoqërisë Australiane Minerare Broken Hill Proprietary (BHP)

2000

Minierat Ivanhoe blejnë 100 për qind Oyu Tolgoi

2001

I pari nga shumë zbulime të arit dhe bakrit

2002-2003

Fillojnë studimet mjedisore



GALERIA E HAPUR NË OYU JUGORE

Kamionët realizojnë 263 ton mineral në një kohë

Në rajonin e Gobit të Jugut të Mongolisë ndodhet miniera Oyu Tolgoi – kantieri më i madh i botës i pazhvilluar i arit dhe bakrit. Bazuar në zbulimet e Minierave Ivanhoe në 11 vitet e fundit, Oyu Tolgoi, e cila do të thotë “kodra e turkezit” në Mongolisht, përmban pothuajse 37 bilionë kilogramë bakër dhe më tepër se 1.3 milionë kilogramë ar.

Ur Revista Cat e vizitoi Oyu Tolgoi, kantieri ishte gati për të kaluar në fazën e operacioneve, megjithëse ishte akoma në fazën e ndërtimit. Janë tre deri në katër vitet e minierës kur ndërtohet infrastruktura fizike për të gjithë

operacionin. Kur të fillojë prodhimi tregtar, në fillim të vitit 2013, miniera pritet të prodhojë si fillim rreth 100,000 ton mineral në ditë nga Galeria e hapur në Oyu Jugore. Ndërkohë, po zhvillohet një minierë gjurmimi me blloqe nën tokë që do të prodhojë 85,000 tonë mineral në ditë. Gjurmimi nën tokë është planifikuar të fillojë në vitin 2017 dhe miniera do të ketë prodhimin e plotë në vitin 2018.

VENDNDODHJA:
OYU TOLGOI
SHKRETËTIRA GOBI,
MONGOLI



2006

Minierat Ivanhoe dhe Rio Tinto PLC njoftojnë ortakërinë

2009

Qeveria Mongoleze po fiton 34 për qind interes tek Oyu Tolgoi

2010

Rio Tinto emërohet menaxheri i kantierit

2012 (Shtator)

Minerali i parë shkon në koncentruar

2017

‘Miniera me blloqe’ nëntokësore do të jetë operacionale



KONVEJERI MBI TOKË

Transporton mineral 2.4 km në ndërtesën e magazinimit të mineralit të papërpunuar

NDËRTESA E MAGAZINIMIT TË MINERALIT

Nga shtypësi fillestar, minerali magazinohet këtu para se të përpunohet më tej

THËRRMUESI I ZEJEVE

Redukton më tej mineralin për përpunim

KOMPLEKSI I KONCENTRUESIT

Përpunimi modern për të punuar bakrin dhe arin

Miniera Oyu Tolgoi është rreth 550 km në jug të Ulaanbaatorit, dhe 80 km në veri të kufirit Mongoli-Kinë.

OYU TOLGOI KAPITALIZON MBI AVANTAZHET E MARRJES ME QIRA



Sipas Oyu Tolgoi, më tepër se 15,000 njerëz janë punësuar gjatë fazës së ndërtimit duke përfshirë 10,000 Mongolezë. Kjo vjen në saj të periudhës së shkurtër kohore dhe nevojës për të krijuar infrastrukturën. Projekti i saj më i madh i ndërtimit në historinë e Mongolisë. Dhe falë minierës, prodhimi i brendshëm bruto i Mongolisë pritet të rritet me 35 për qind ku pjesa më e madhe e mineraleve shkojnë në Kinë.

WAGNER ASIA I PËRGJIGJET OKAZIONIT

Një minierë ekspansive e kësaj shkalle do të thotë se nevojitet krijimi i një infrastrukture të madhe. Ky është një rast i madh për Wagner Asia. E krijuar në vitin 1996 me seli në kryeqytetin e Ulaanbaatarit, Wagner Asia është tregtari zyrtar i Cat® në Mongoli. Tregtari Cat u rrit bashkë me zhvillimin e vendit. Dhe kur Mongolia arriti bumin mineral, Wagner Asia pa një rritje të mprehtë të nevojës për makina dhe pajisje me qira, si një opsion që do të sillte vlerën dhe zgjidhjet e duhura tek klientët.

Sot, një prej klientëve të tyre më të mëdhenj është miniera Oyu Tolgoi. "Jemi përfshirë me Oyu Tolgoi në një mënyrë ose një tjetër që prej fillimit. Kemi një gamë të gjerë pajisjesh të përfshira atje për krijimin e infrastrukturës. Meqenëse ata janë një operacion i

vetëmjaftueshëm në një zonë të largët, makinat Cat po ndihmojnë në ndërtimin e centraleve elektrike, rrugëve, ndërtesave, madje edhe një aeroport dhe shumë projekte të tjera industriale që lidhen me operimin e minierës," thotë Steve Potter, Drejtor i Përgjithshëm i Wagner Asia Equipment LLC.

NJË PARTNERITET I SUKSESSHËM FILLON ME MARRJEN ME QIRA

Ndërkohë që marrëdhënia midis Wagner Asia dhe Oyu Tolgoi ka qenë gjithmonë e fortë, tregtarët e ndjenë se ishte e rëndësishme që të jepej një mbështetje edhe më e mirë për kantieret e largëta minerare. Në fund të fundit, kur një klient i madh si Oyu Tolgoi është më tepër se 500 kilometra larg, është e vështirë që t'i jepet ai lloj shërbimi dhe mbështetjeje për të cilat Caterpillar® është kaq i famshëm. Tselmun G., Drejtor i Dhënies me Qira dhe Divizionit të Pajisjeve të Përdorura, na tha, "Shoqëritë e tjera po menaxhonin dhe po u kryenin servise pajisjeve nga Ulaanbaatari. Kështu, ne vendosëm që të hapim një degë në Khanbogd, i cili është shumë më afër me klientin tonë. Kemi makina atje. Kemi teknikë atje. Kemi pjesë atje. Të gjitha këto janë për të mbështetur pajisjen tonë me qira. Kjo bën një dallim të madh."

STEVE POTTER

Drejtor i Përgjithshëm i
Wagner Asia Equipment LLC



Thjesht pse Oyu Tolgoi zgjodhi të merrte me qira kaq shumë pajisje në vend që ti blinte ato? Atëherë, ka shumë arsye. Duke marrë me qira makinat, Oyu Tolgoi redukton risqet e pajisjeve që vijnë me pronësinë që shoqërohet me ndërtimin e infrastrukturës në kantier. Duke i mbajtur ato risqe Wagner Asia, miniera mund të fokusohet në përfundimin e fazës së ndërtimit. "Puna vazhdon 24/7 në Oyu Tolgoi. Kështu, ndërsa një makinë tipike e marrë me qira mund të punojë 15 deri në 2,000 orë në vit, një marrje me qira me kontratë, siç gjeni në minierë, do të punojë për 6,000 orë në vit. Në mënyrë definitive ato ndjekin ritmin e tyre," tha Steve.

Një përfitim tjetër është fakti se nevojat e prodhimit mund të plotësohen lehtësisht në varësi të kulmeve të ndërtimit dhe se çfarë makinash nevojiten. Me fjalë të tjera, duke marrë qira, Oyu Tolgoi merr llojin dhe numrin e makinave kur i nevojiten. Në këtë mënyrë, pajisjet nuk qëndrojnë përreth të papërdorura. Steve ofroi këtë interpretim, "Marrja me qira jep një opsion fleksibël krahasuar me shitjet tërësore – edhe për dikë si Oyu Tolgoi që do të jetë këtu për 60 deri në 100 vitet e ardhshme. Në qoftë se përdornin pajisje për një projekt afatshkurtër, ju nuk doni që të ngarkoheni me atë kapital."

Veç kësaj, disponueshmëria e një game të gjerë pajisjesh është e rëndësishme. Në Prill të vitit 2010 ishin rreth 700 njerëz që punonin në kantier. Gjatë kulmit të fazës së

ndërtimit, ishin më tepër se 14,000. "Nxjerrja e mineralit këtu ka një bum. Na nevojiteshin pajisje. Minierat e qymyrit kishin nevojë për pajisje. Makineritë nevojiteshin për ndërtimin e rrugëve. Kontraktuesit kinezë sollën rreth 600 pajisje. Askush nuk mund të parashikonte se çfarë do të nevojitej më pas. Marrja me qira ishte një zgjidhje e shkëlqyer nga ne. Jo vetëm nga pikëpamja e disponueshmërisë, por edhe sepse edhe për shkak të kohës për manovrim dhe livrim," theksoi Dale Derby, Menaxheri i Operacioneve dhe Mirëmbajtjes për Oyu Tolgoi. Rezultati është se duke qenë një furnizues me një burim të vetëm që plotëson shumë nevoja, Wagner Asia kthehet në një partner biznesi më i vlefshëm.



Dega në Khanbogd e Wagner Asia u krijua në Mars të vitit 2009. E ndodhur vetëm 40 kilometra larg nga miniera, vendndodhja e qiradhënies u hap për të ndihmuar që të funksiononte ndërtimi i minierës me rendimentin më optimal. "Një gjë që e bën këtë histori sukses është fakti se ne kemi investuar në vendosjen e një dege pranë klientit tonë. Ne donim që njerëzit dhe pjesët t'i vinim më afër makinerisë sesa ndonjë tjetër," tha Steve.

"Makinat Cat po ndihmojnë për ndërtimin e centraleve elektrike, rrugëve, ndërtesave, madje edhe një aeroport. . ."

Steve Potter, Drejtor i Përgjithshëm i Wagner Asia Equipment LLC

Për të hapur degën, Wagner Asia bëri investime të mëdha. "Kemi investuar rreth \$700,000 në degën Khanbogd. Por po investojmë rreth 9 milionë \$ në kampin fushor me 425 vetë, i cili do të ndërtohet për punonjësit tonë për një afat të gjatë. Ai do të përfshijë strehimin, kafenetë, fushë basketbolli, dyqan ushqimesh, sistemin septik dhe çdo gjë tjetër," tha Chris Foster, Drejtori Teknik për Wagner Asia. Nga fundi i vitit 2013, pritet që të jetojnë në këtë kamp 250 vetë.

Dega Khanbogd operon gjithashtu Magazinën Cat për Dhënie me Qira dhe tipikisht ka rreth 45 copë pajisjesh Cat për dhënie me qira dhe 30 produkte të ndërtimit të ndërtesave në dispozicion. Vendndodhja ka menaxherin e dedikuar të vetë degës, koordinatorin e dhënies me qira, koordinatorin e pjesëve dhe shtatë teknikë si staf. Dega e tregtisë së Cat gjithashtu ka një oficinë me servis të plotë dhe banakun e pjesëve si dhe një ambient zyre dhe akomodime për punonjësit rezidentë dhe miqtë. Dega e Khanbogd është një avantazh i madh për Oyu Tolgoi. Atje ne kemi teknikë si dhe në kantierë në minierë, kështu ne mund të zgjidhim problemet në çdo kohë të ditës ose të natës," shtoi Chinbat Ts, Përfaqësuesi i Shitjeve me Llogari të Mëdha.

Pajisjet Cat u kryhet servisi në oficinën në kantier të Wagner Asia.



Tselmun G., Drejtor i Divizionit të Dhënies me Qira dhe Pajisjeve të Përdorura, shpjegon rëndësinë e biznesit të dhënies me qira të Wagner Asia dhe degës së tyre në Khanbogd.





“Wagner e kupton rëndësinë e të qenit një partner proaktiv.”

DALE DERBY

Menaxher i Operacioneve dhe Mirëmbajtjes Oyu Tolgoi LLC. Wagner Asia ndihmon që operacionet të ecin pa probleme dhe është një partner i parapëlqyer për pajisjet e mara me qira.

MBËSHETJA NË VEND E PRODUKTIT ZGJIDH SFIDAT E MIRËMBAJTJES

Krijimi i një infrastrukture për një operacion të kësaj madhësie është një detyrë e vështirë. Çdo gjë që nga lugët dhe pirunët deri tek makineritë e mëdha duhet të merren në konsideratë. Rugët duhet të krijohen. Ndërtesat duhet të ndërtohen. Tubacionet dhe kabllot duhet të futen nën tokë. Duket si një listë e pafund.

Disponueshmëria është kyçi kur vjen fjala tek marrja me qira, por kur makinat janë në vendin e punës, atëherë gjithçka është në lidhje me besueshmërinë. “Gjatë ndërtimit, kemi vetëm 4 për qind kohë pa punë, e cila është shumë e padëgjuar, kështu që pasja e pjesëve në dispozicion është kritike. Kryesisht ne ndërtojmë një magazinë që mban mesatarisht 14 milionë dollarë vlerë të pjesëve. “Shumica e mallit gjendje ishin vegla për të punuar në tokë, ose GET,” thotë Dale. “Malli” të cilit ai i referohet përfshin mjete si thika, presa dhe dhëmbë. “Është e vështirë që të gesh mbështetje në vend për të gjitha pajisjet që ne kemi, ne operojmë me më tepër se 100 pajisje, që është një tjetër arsye përse duhet të ndërtonim magazinën tonë të mallrave gjendje.”

Për Dale, besueshmëria do të thotë një gjë – makinat të punojnë kur duhet. Sa më e besueshme është një makinë, aq më shumë kohë pune jep ajo. Për të ndihmuar maksimizimin e rendimentit, Wagner Asia punon në oficinën në terren të Oyu Tolgoi në mënyrë që mirëmbajtja parandaluese, servisi dhe pajisjet të mund të bëhen sa më shpejt që të jetë e mundur. “Oficina në Oyu Tolgoi është shumë e rëndësishme. Kemi rreth 50 copë pajisje Cat të marra me qira atje. Ne përgjigjemi për të gjithë mirëmbajtjen, pjesët, riparimet, çdo gjë. Pasja e një fasiliteti atje me stafin tonë të teknikëve të cilët mund të trajtojnë gjithçka që del do të thotë se ne mund të kryejmë servilin për klientin në mënyrë më eficiente dhe ta mbajmë rendimentin në një nivel të lartë,” shtoi Ulziisaikhan, Menaxher i Degës Khanbogd.

Në varësi të madhësisë së pajisjes, oficina mund të mbajë deri në tetë makina në një kohë. Teknikët e Wagner Asia kryejnë servilin e rreth 15 makinave çdo ditë. Ata janë 10 orë në turne dite dhe nate me rreth 14 teknikë që punojnë në secilin prej tyre.

Pavarësisht llojit të makinave Cat, servisi kryhet në çdo 250 orë. Brad Turner, Këshilltari Madhor për Mirëmbajtjen e Lëvizshme për Oyu Tolgoi shpjegon, “Ne e shtyjmë kohën e mirëmbajtjes normale parandaluese për shkak të pluhurit dhe të klimës këtu. Makinat tona punojnë rreth 15 deri në 18 orë në

“Marrja me qira ishte një zgjidhje e shkëlqyer për ne.”

Dale Derby, Menaxher i Operacioneve dhe Mirëmbajtjes, Oyu Tolgoi LLC

ditë kështu që mirëmbajtja parandaluese ndihmon që të mbajë çdo gjë në funksionim dhe ne mund t'i kapim problemet përpara se ato të bëhen probleme të mëdha. “Orët e gjata të operimit dhe pushtimi konstant i makinave nga rëra e shkretëtirës përkeqësohen nga lëkundjet dramatike të temperaturës në këtë zonë. Gjatë verës, temperatura mund të shkojë deri afër 40° C dhe të zhytet deri në -30° C në dimër.

DISPONUESHMËRIA E PJESËVE MERR NJË KUPTIM KREJTËSISHT TË RI

Edhe pse Mongolia është më tepër se 604,000 milje katrorë, ajo është përsëri një vend i largët në zemër të Azisë. Madje edhe më të largëta janë dega Khanbogd e Wagner Asia dhe miniera Oyu Tolgoi. Kjo do të thotë se marrja e pjesëve mund të jetë për ta thënë me delikatesë, sfiduese. “Nuk janë thjesht distancat e mëdha, mungesa e rrugëve apo verat dhe dimrat e ashpër. Ka gjithashtu edhe probleme

Ajjsja Cat ndihmon në ndërtimin e pistës për Aeroportin e ri Oyu Tolgoi Khanbumbat.



MAKINAT CAT TË MARRA ME QIRA NË

MINIERËN OYU TOLGOI:

13 ngarkues me rrota
8 kamionë për rrugë të vështira
8 gradues motorikë
7 ekskavatorë hidraulikë
7 traktorë të tipit me zinxhirë
5 traktorë me rrota skrap
4 telemanovrues
4 kompaktësues dheu vibrues
1 makinë e artikulluar me zinxhir
1 ekskavator me rrota
1 ngarkues me timon të rrëshkitshëm

MAKINERITË E REJA CAT NË KANTIER:

11 ngarkues me rrota
4 moto gradues
2 ekskavator hidraulikë
1 telemanovrues
1 traktor i tipit me zinxhir

MAKINA CAT TË PËRDORURA NË KANTIER:

4 kamionë për rrugë të vështira
3 ngarkues me kovë
3 telemanovrues
2 ngarkues me rrota
2 ngjeshës dheu
1 ekskavator hidraulik
1 traktor i tipit me zinxhir
7 ngjeshës dheu vibrues



rregullatore. Nuk mund të shkosh në Mongoli pa kaluar kufijtë Rus dhe Kinezë,” vuri në dukje Steve.

Wagner Asia është në një cikël 90-ditësh për shumicën e porosive stok. Sfidat më të mëdha të pjesëve, megjithatë janë situatat e emergjencës. Aeroporti që aktualisht i shërben degës së Khanbogd dhe minierës Oyu Tolgoi mund të trajtojë aeroplanë relativisht të vegjël, kështu që hapësira e ngarkesës është në një prim. Një aeroport i ri është aktualisht në ndërtim e sipër (duke përdorur pajisjet Cat), por deri sa ai të jetë operacional, Wagner Asia i sjell pjesët nga Pekini, Kina dhe livrimin përfundimtar e bën me hekurudhë ose me rrugë. “Kolegët tanë në Denver, Kolorado kanë një qendër distribucioni 20 minuta poshtë rrugës. Idea e tyre e një emergjence është në qoftë se pjesët nuk janë atje në të njëjtën ditë. Ne bëjmë mirë që i sjellim pjesët këtu brenda pesë ditësh. Është një ushtrim i vazhdueshëm që ne shikojmë se si mund ta bëjmë më mirë krahasuar me dje,” shtoi Steve.

Kështu, cila është perspektiva për disponueshmërinë dhe livrimin e pjesëve nga pikëpamja e një klienti? Ne edhe një herë ju kthjem Dale për përgjigje. “Kjo varet nga ai që merret me to. Ka raste kur në qoftë se ne marrim diçka brenda gjashtë javësh, neve do na ecë puna mjaft mirë. Megjithatë, shumë shpesh, Wagner Asia mund t’i çonte pjesët në një avion dhe t’i sjellë ato këtu përpara se të merrnin edhe urdhrin e porosisë. Konkurruesit thjesht nuk i kanë mallrat.” Një përfitim i Wagner Asia është sistemi tavan i tregtarëve, i cili i lejon Dale dhe ekipit të tij që të lidhet me pjesët gjendje të tregtarëve direkt në mënyrë që ata ta dinë çfarë është e disponueshme dhe kur. Wagner Asia gjithashtu ishte e para që e pajisi Oyu Tolgoi me një person në terren për pjesët i cili përgjigjet për mirëmbajtjen e mallrave gjendje dhe vepron si një linjë direkte e kontaktit për klientin.

NJË TREGTAR CAT I CILI ËSHTË GJITHASHTU NJË DHËNËS I ZGJIDHJEVE

Për Oyu Tolgoi, Wagner Asia është më tepër se sa thjesht një shitës ose një vijë në një tabelë shifrash; ai është gjithashtu një dhënës zgjidhjes. Në qoftë se Oyu Tolgoi ka nevojë për pjesë, Wagner Asia i furnizon ato. Në qoftë se një makinë ka nevojë për shërbim, ofiçina në terren e Wagner Asia e kryhen atë. Në qoftë se kërkohen pajisjet e reja, të përdorura apo të merren me qira, livrimi bëhet në kohë dhe sipas nevojave të klientit dhe përdorimit të makinës.

Wagner e kupton rëndësinë e të qenit një partner proaktiv. Se sa në vend që të rijë të presë dhe të shpresojë që biznesi që i Oyu Tolgoi të vijë tek ata, ata e sillen biznesin e tyre tek Oyu Tolgoi – në kuptimin e plotë të fjalës. “Të punosh me Wagner Asia është një sukses i plotë. Kur ne parashutuam pajisjet dhe njerëzit këtu gjithmonë ka pasur vonesa. Por Ëagner, vërtetë me ndershmëri ishte gjithmonë atje të na mbështeste ne me këtë. Mendoj se provuam të gjitha shoqëritë e tjera për marrje me qira dhe nuk na eci mirë. Por Ëagner ka qenë gjithmonë e mirë,” thotë me besim Dale. ■

ULZISAIKHAN

Menaxher i Degës Khanbogd,
Wagner Asia Equipment LLC.

Një ushtri e vogël kamionësh për rrugë të vështira 773D ndihmon në avancimin e operacioneve të landfillit.





FAZA NJË

NGROHJA PËRPARA UDHËTIMIT MË TË FTOHTË NË TOKË



Sir Ranulph Fiennes, i quajtur aventurieri më i madh i gjallë i botës, do të udhëheqë Udhëtimin më të Ftohtë mbi Tokë.

Kjo është e para histori e një serie prej pesë historish që mbulojnë "Udhëtimin më të Ftohtë mbi Tokë." Do të ndjekim Sir Ranulph Fiennes dhe ekipin e tij prej gjashtë eksploruesish ndërsa përpiqen të bëjnë kalimin e parë që është bërë ndonjëherë në dimër në Antarktikë. Është një udhëtim epik prej gjashtë muajsh, 2000-milje, shumica e të cilit do të kryhet në errësirë të plotë. Dy traktorë të tipit me zinxhirë Cat® D6N të modifikuar në mënyrë speciale po shoqërojnë ekspeditën.

AVENTURA THËRRET

Sir Ranulph Fiennes dhe ekspedita e tij u nis nga Londra në Dhjetor 2012, megjithatë, ekipi nuk do të shkelte në kontinentin e ftohtë deri nga fundi i Marsit 2013. Revista Cat do t'j ndjekë nga pas, figurativisht, sigurisht, ndërkohë që ekipi, duke përfshirë dy inxhinierë Finning luftojnë me erën e pamposhtur dhe temperaturat tepër të ftohta deri në -70°C.

Sfida më e madhe mund të jetë akoma përpara, por ndoshta pjesa më e rëndësishme e udhëtimit nuk është udhëtimi fare. Është planifikimi, përgatitja dhe trajnimi të cilat i tregojnë kjo histori.

TREGTARI CAT FINNING I MBRETËRISË SË BASHKUAR KËRKOI QË TË JETË ANËTAR I EKSPEDITËS

Për të përfunduar me sukses një ekspeditë të kësaj përmase, është kritike që të kesh pajisje të besueshme. Për të ndihmuar për të çarë rrugën Sir Ranulph Fiennes i besoi aftësive të dy Cat D6N. Nuk është nevoja ta themi,

Finning UK, që e furnizoi ekspeditën me të dy makinat bashkë me mirëmbajtjen, shërbimin dhe dy inxhinierët ishin krenarë që të ishin partnerë të ekspeditës. Është një testament për besueshmërinë e pajisjeve Cat dhe ekspertizën e mbështetjes së Finning UK.

PËRGATITJA E D6N PËR KUSHTET EKSTREME

Si linja e jetës së ekspeditës, secili Cat D6N do të tërheqë vagona specialë që mbartin ushqim, strehim, pajisje dhe 70,000 litra karburant. Traktorët e tipit me zinxhirë u zgjodhën për aftësinë e tyre për të performuar – gjithë

... shumica e ekspeditës do të jetë në errësirë të plotë.

ditën, çdo ditë. Anëtar i ekspeditës, Spencer Smirl, Inxhinier i Finning Kanada, ndau disa nga avantazhet e D6N. "Mendoj se ato u zgjodhën për raportin e tyre fuqi-peshë. Dhe për shkak të akullit të detit dhe të çarave, duhen makina të lehta. Një faktor i madh gjithashtu ishte ekonomia e karburantit udhëheqës në industri, meqenëse ne po tërheqim karburantin tonë."

Makinat u testuan në Arjeplog, Suedi dhe u pajisën me radar që penetrojnë tokën për të identifikuar fusha me humnera dhe të çara. Secila u modifikua me përshtatje që bateritë të mos humbnin fuqinë dhe për të parandaluar këputjen e rripave të shtytjes. Testet përfshijnë gjithashtu masat e djegies të karburantit dhe ushtrime





Zbuloni më tepër për Udhëtimin më të Ftohtë në Tokë dhe ndiqni ekspeditën në thecoldestjourney.org dhe në ourcoldestjourney.com

Për më tepër informacion, kontaktoni Gabriela De Paula via De_Paula_Gabriela@cat.com.

17 Shtator 2012:

Njoftimi në BBC, press launch at London's Royal Society

20 Nëntor 2012:

Anije furnizimi në Antarktikë, SA Agulhas, mbërrin në Londër

06 Dhjetor 2012:

Princi Charles viziton SA Agulhas përpara se anija të niset nga Londra

22 Dhjetor 2012:

SA Agulhas mbërrin në Cape Town, Afrika e Jugut

31 Dhjetor 2012:

Ngarje mediatike në Cape Town

14 Janar 2013:

SA Agulhas mbërrin në bazën Ruse të Antarktikut, Novilazarevskaya

21 Mars 2013:

Vendosja e këmbës së parë të sfidës

Qershor/Korrik 2013:

Grupi i Akullit mbërrin në Polin e Jugut

21 Shtator 2013:

Grupi i Akullit mbërrin në McMurdo Sound

Nëntor 2013 – Mars 2014:

Grupi i Akullit kthehet në Londër



Sir Ranulph Fiennes (i 5 nga e majta) me ekspeditën e tij dhe ekipet e trajnimit në Suedi.

të manovrueshmërisë nëpërmjet një fushe të cacrash të krijuara vetë ndërkohë që tërhiqeshin 17 ton. Spencer shtoi, "Ne provuam gjithashtu zgjerimet në tërheqje dhe çadrat termale të përdorura për të mbuluar makinat kur kryhet mirëmbajtja dhe ishim të kënaqur me rezultatet."

NJERËZIT QË DO TË OPEROJNË MAKINAT

Makinat Cat nuk ishin të vetmet që anëtarët e ekipit testuan. Dy inxhinierëve Finning ju desh të duronin testimin fizik dhe mendor për të siguruar që ata do të mund t'i përballojnë streset dhe sfidat ekstreme të këtyre kushteve gjytmuese. "Duke qenë nga Kanadaja Veriore unë nuk e kam frikë këtë klimë, por unë nuk e respektoj atë," tha Spencer.

Gjatë tre javëve, instruktorët e Finning UK krijuan gabime në një D6N për të testuar aftësinë e inxhinierëve për të performuar nën presion. Dhe për të parë se si performojnë inxhinierët në të ftohtë, ata kaluan 14 ditë të ftohta Shkurti në Arjeplog, Suedi duke punuar me një D6N. Spencer rikujton, "Ata vlerësuan personalitetet tona dhe gjendjen mendore kur ne ishim më të dobët – të ftohtë dhe të lodhur."

MOTIVIMET PAS VULLNETARIZMIT

Përse dikush bëhet vullnetar për këtë ekspeditë kaq ekstreme? Spencer tha "Është një rast i rrallë të jesh pjesë e ekipit të parë për ta përbushur me sukses këtë udhëtim. Është diçka që unë se kam parë veten që ta bëj. Unë gjithmonë kam dashur që të garoj në diçka. Kurrë nuk e kam menduar që do

të ishte përmes Antarktidës në një buldozer. Kjo më jep një sens të madh të krenarisë së shoqërisë."

MISIONET Kryesore të Ekspeditës

Ekspedita ka dy qëllime kryesore. Njëri është që të mbledhë të dhëna për ta çuar më tej kuptimin e ndryshimit të klimës dhe efekteve të saj. Tjetri është që të mbledhë 10 milionë dollarë për të Shikosh është të Besosh, një iniciativë globale që ndihmon në trajtimin e verbërisë së shmangshme në të gjithë botën.

Kur të mbërrijmë tek numri i Majit 2013 të Revistës Cat, ne do t'ju shoqërojmë ndërkohë që ekspedita bën hapat e para drejt Polit të Jugut ndërkohë që ne do të kontrollojmë progresin e tyre. Si po ja dalin ata me të ftohtin ndëshkues? Me çfarë sfidash dhe rreziqesh janë përballur? Kjo e gjitha është në numrin tjetër ndërkohë që realitetet e një marshimi prej 2,000-miljesh mbërthejnë ekipin. ■

CAT SHKURTIMISHT



MAKINA TË VOGLA NDËRTIMI PUNA NË MAJË TË BOTËS



Kur Pon Equipment Norvegji mori një porosi livrimi për tre makina kompakte, (një 301.8C, një 308D CR Swing Boom dhe një 906H High Flow), ishte biznes si zakonisht, megjithëse ai livrim drejtohej për në paralelin 78 të globit në veri. Makinat mbërritën për detyrën për të mbështetur pajisjen më të madhe Cat® (2 traktorë të tipit me zinxhirë, 8 ngarkues me rrota, 5 kamionë për rrugë të vështira 2 ekskavatorë hidraulikë) në mjediset e portit Svea në Svalbard, Norvegji. Megjithatë, siç pritej ka shumë sfida që veprojnë kaq larg në veri.

Svalbard është një arkipelag në mes të rrugës midis majës së Norvegjisë dhe Polit të Veriut. Temperaturat shumë të ulëta (një mesatare e ulët prej -10° C), do të thotë që makinat janë pajisur me start të ftohtë dhe sisteme pas startimit. Një sfidë e papritur megjithatë, është ajri i thatë, i cili than pjesët prej gome të makinave, duke i bërë ato të thyeshme.

Po kështu, Pon kryhen inspektime shtesë rutinë dhe mban gati gjendje shumë komponentë prej gome. Veç kësaj, tregtari ka një teknik servisi në terren gjatë gjithë kohës kështu që problemet me flotën e klientit mund të trajtohen menjëherë ose mund të parandalohen tërësisht.

TELEFONAT E RINJ CELULAR CAT JANË TË FORTË NË TË FOLUR

Ju mund t'i rrëzoni ata, ti fusni në ujë apo ti ekspozoni në pisllek dhe pluhur. Telefonat e rinj Cat® ja dalin të gjitha këtyre, duke ruajtur reputacionin e Cat për jetëgjatësinë dhe besueshmërinë. Të dy modelet e rinj janë Cat B10 dhe Cat B25. Në detyrë ose në lojë, të dy janë të projektuar që ti rezistojnë mjedisve të forta në kantierët e punës si dhe rrëzimeve të përditshme në jetë, rrokullisjeve apo goditjeve.

CAT B10

I ndërtuar për të jetuar pa sakrifikuar tiparet apo funksionalitetin. Një trup i përfurcuar mbron B10 nga goditjet, ai mund t'i mbijetojë zhytjes në ujë, në një metër ujë për 30 minuta dhe telefoni nuk përshkohet nga pluhuri.

Cat B10 është një pajisje serioze dhe ka:

- Një sistem operues Android
- Ekran me shumë prekje kapacitues
- Një kamera për të parë nga pas me 5.0-megapixel dhe një kamera për të parë nga para me 0.3-megapixel
- Akses në më shumë se 500,000 apps

CAT B25

Në qoftë se e doni kompakt ose të drejtpërdrejtë ky është telefoni për ju. Cat B25 ka një tastierë më tradicionale por ai përsëri është i ngarkuar me gjëra të mira që përfshijnë një ekran 2 inch dhe një kamera 2.0-megapixel që mund të bëjë video.

Veç kësaj, ka një ruajtje të zgjerueshme deri 8GB, një dritë treguese të ndërtuar brenda dhe një altoparlant për të mos e mbajtur në dorë. Ashtu si B10, dhe B25 i mbijeton zhytjes në një metër ujë për 30 minuta dhe nuk përshkohet nga pluhuri.

Për të gjitha specifikimet dhe detajet, për më tepër informacion dhe për të marrë përditësimet, regjistrohuni në catphones.com.



PORTOKALLJA [ORANGE] E KLIENTIT TË JORDAN TRACTOR BËHET JESHILE



SISTEMI HIBRID I TRAKTORIT TË JORDANISË:

- Qeliza diellore 7 kW fotovoltaik
- Tre turbina ere të montuara (1 kW secila)
- Dy banka baterie me 24 bateri (gjithsej)
- Një gjenerator Cat 13.5 kVA në pritje

Një orë në perëndim të Karakut, Jordani, dhe rreth 150 kilometra në jug të Ammanit, është një kullë e vetme telefoni celular. Ajo quhet 63AQ. Dhe, këtë zonë të largët të kesh pajisje që ndihmon njerëzit të komunikojnë në mënyrë të besueshme është e rëndësishme. Kulla është pronë dhe operohet nga Orange. Kur shikon për herë të parë 63AQ, duket thjesht si çdo kullë tjetër celulare, përveç një detaji të rëndësishëm – furnizimi me energji i kullës vjen nga sistemi hibrid i furnizuar nga Caterpillar®.

Caterpillar ka shumë përvojë në përdorimin e gjeneratorëve për të furnizuar me energji në mënyrë të besueshme stacionet bazë të largëta të telekomunikacionit. Por numri i stacioneve të largëta që nuk kanë akses në rrjet po rritet me shpejtësi. Si rezultat, shoqëritë si Orange po shikojnë për alternativa ndaj gjeneratorëve që djegin karburant diesel të kushtueshëm. Gjithnjë e më tepër ata po kërkojnë energji të besueshme, me kosto efektive dhe Cat® ofron lloje të ndryshme të sistemeve hibrid.

TREGTIMI I ENERGJISË DIEZEL PËR ENERGJINË HIBRIDE

Më parë kulla 63AQ furnizoi me energji duke përdorur dy komplete gjeneratorësh konvencionalë, të cilët konsumonin rreth 1,800 litra karburant diesel dhe 16 litra vaj motori në muaj. Veç kësaj, stafi teknik i Orange duhet të shkonte në kantier çdo muaj për të zëvendësuar karburantin e përdorur dhe për të kryer ndonjë mirëmbajtje që nevojitej. Kjo ishte e kushtueshme dhe harxhonte kohë.

Pastaj, gjatë një vizite tek tregtari Cat Traktori i Jordanisë, Tamer Nasr, Kryemenaxheri i Departamentit të Sistemit të Energjisë, i tregoi përfaqësuesve të Orange për sistemin hibrid të furnizuar nga Caterpillar. "Orange ka vendet e furnizuara me energji diellore. Por, ata ishin shumë të interesuar në potencialin që ofronte sistemi ynë hibrid. Me rritjen e çmimeve të karburantit dhe një jetë operacionale prej dy vitesh përpara se kompletëve të gjeneratorëve tu nevojitej një riparim i përgjithshëm, Orange na kërkoi që të bënim një propozim".

Jordan Tractor ju fut punës për të hartuar opsione të ndryshme të konfiguracionit hibrid dhe projekto plane në vend përpara se të bënim një prezantim. "U desh të bëhej shumë punë inxhinierike për të krijuar sistemin më efektiv. Ne studiuam gjithashtu hartat e erës dhe të intensitetit të diellit. Çdo gjë duhet të funksiononte së bashku," shtoi Tamer. Menjëherë pas dy muajsh, 63AQ operoi me energji diellore dhe të erës.

KURSIMI I EMETIMEVE DHE KURSIMI I PARAVE

Sistemi hibrid përdor një kontroll inteligjent nga larg Cat dhe një sistem monitorimi, disa panele diellore fotovoltaike (7 kE gjithsej), tre turbina ere (1 kW secila)

"Ne eliminuam emetimet CO₂ dhe gjeneratori mbështetës nuk është nevojitur gjatë 16 muajve të fundit."

Aziz Aranki, Menaxher i Operacioneve Power & A/C tek Orange

dhe dy banka baterie. Panelet diellore dhe turbinat e erës garantojnë energji që nuk ka emetime karboni dhe janë burimet kryesore të energjisë së përdorur për të karikuar bankat e baterisë. Bateritë nga ana e tyre furnizojnë me energji pajisjet e telekomeve. Dhe në qoftë se nuk ka diell ose erë, bateritë mund të furnizojnë me energji kullën për deri në katër ditë. Ndodhet gjithashtu një gjenerator diesel Cat13.5 kVA (në gatishmëri), i cili mund të mbajë 63AQ dhe të funksionojë ajo për 40 ditë.

Qëllimi i projektit është që të bëhet një përdorim më eficient i burimeve natyrore të botës dhe të reduktohet impakti i panevojshëm mbi mjedisin. Kjo po funksionon mirë. Falë një drejtpeshimi të kujdesshëm të llogaritit të energjisë diellore dhe të erës, sistemi operon në mënyrë të përsosur gjatë verës dhe dimrit.



“Në verë shumica e energjisë vjen nga dielli dhe në dimër shumica e saj vjen nga era,” shtoi Tamer.

Që kur mbërriti energjia nuk është konsumuar karburant diesel as vaj për motorin dhe nuk ka pasur nevojë për riparime. Aziz Aranki, Menaxher i Operacioneve të Power & A/C në Orange Jordani gjithashtu theksoi suksesin e projektit: “Sistemi u instalua gjatë Majit 2011. Gjatë vitit të parë të operacionit, kishim një reduktim prej €20,000 në shpenzimet e operimit. Veç kësaj, eliminuam emetimet e gazit CO₂ dhe gjeneratorët mbështetës nuk janë nevojitur asnjëherë gjatë 16 muajve të fundit.”

Ka pasur një reduktim të madh në kostot operuese mujore. Për shembull, furnizimi me energji i 63AQ që përdorin të dy kompletet e gjeneratorit diesel kushton rreth \$2,400 në muaj. Sistemi hibrid megjithatë kushton vetëm \$100 në muaj.

MONITORIMI NË VEND

Ndërsa pajisja në 63AQ ishte relativisht e re, u kryhen vizita mujore të shpejta përsëri për të kontrolluar vizualisht pajisjen. Tani nuk është e nevojshme. “Nuk ka servile apo riparime për tu bërë. Dhe meqenëse pajisja nuk konsumon ndonjë karburant, nuk ka asgjë për tu rimbushur. Dhe vendi automatikisht na dërgon raporte të plota në mënyrë elektronike për performancën e tij operuese, të cilat ne ja kalojmë Orange,” thotë Tamer.

SISTEMET E STANDARDIZUARA PËR NJË TREG NË RRIJJE

Caterpillar do të lëshojë kryesisht zgjidhje hibride standarde të volumit të lartë për rrjetin e Tregtarit Cat. Në disa raste Caterpillar dhe tregtarët Cat do të ofrojnë zgjidhje të përshtatura për projektet specifike dhe me objekt,” vazhdoi të thoshte Tamer. Duke ditur që numri i stacioneve bazë të largëta të telekomunikacionit është në rritje, është e sigurt të themi se Jordan Tractor do të konfigurojë një gamë të gjerë të sistemeve hibride në të ardhmen e afërt. ■



NJË EVOLUCION PËR DY DEKADA I EKSKAVATORËVE CAT ME RROTA

Nga e Maja në të Djathtë: Peter Gerstmann, Drejtori Ekzekutiv i Zeppelin; Werner Baumann, Drejtori Ekzekutiv i BMTI CEO; Bernd Karsten, Menaxheri Teknik i BMTI dhe Brian Abbott, Menaxheri i Produktit të Caterpillar Wackersdorf me ekskavatorët me rrota gjatë festimit të dorëzimit.

Caterpillar® ka prodhuar ekskavatorë me rrota që në vitin 1992. Dhe sot, ata janë më popullorë se kurrë. Gjermania vazhdon si tregu më i madh i ekskavatorëve me rrota, por, ekonomi të tjera në zhvillim, të tilla si Afrika dhe Lindja e Mesme (AME), Komënuelthi i Shteteve të Pavarura (CIS) dhe Azia po rriten dhe zhvillohen.

Klientët që përdorin ekskavatorët me rrota Cat® i përdorin ato për disa detyra. "Njerëzit që e blejnë këtë lloj pajisje punojnë me bashkitë ose zonat metropolitane," thotë Randall Crow, Marketingu i Produktit për Gërmimet në Gjenevë. "Këto makina janë të përsosura për të punuar në hapësira të ngushta, me kanale nëntokësore, për gradime të holla, riparimin e rrugëve të qytetit; të gjitha këto përbëjnë shumëllojshmëri. Veç kësaj, ekskavatorët me rrota Cat kanë kapacitetin ngritës më të mirë të klasës dhe janë shumë eficientë për karburantin."

Një avantazh tjetër i ekskavatorit me rrota është shpejtësia. Ai nuk do të fitojë ndonjë garë të Formula 1 por mund të udhëtojë deri në 37kph. Brian

Abbott, Menaxher i Produktit në Mbarë botën për ekskavatorët me rrota Cat shtoi, "Dy prej tërheqjeve më të mëdha të ekskavatorit me rrota janë se ai mund të drejtohet në rrugë publike dhe ai mund të lëvizë lehtësisht përreth kantierit të ndërtimit."

NGA E KALUARA NË TË TASHMEN

Në fund të viteve 1980, Tregtari Gjerman i Cat Zeppelin hyri në biznesin e ekskavatorëve me rrota. Ndërtuar nga ai që tani është një konkurrues i Caterpillar, atyre ju vu emri i markës Zeppelin. Caterpillar menjëherë e pa suksesin që pati Zeppelin dhe krijoi ekskavatorin e vet me rrota Cat duke përdorur një kontraktues tjetër.

Disa vite më vonë në 1994, u lançua platforma e parë Cat M300, ndjekur nga brezi tjetër M300C në fillim të viteve 2000. Në vitin 2005, Caterpillar inkurajuan partnerët e tjerë dhe e lëvizën prodhimin në fabrikën e tyre në Grenoble, Francë.

Seria M300D pasoi së shpejti në vitin 2007 dhe plotësoi kërkesat emetimit Stage IIIA. Kohët e fundit, Caterpillar



SMARTBOOM™, EMRI FLET VETË

Një faktor kryesor që bën dallimin e ekskavatorëve me rrota Cat është SmartBoom. SmartBoom "mendon" për operatorët në mënyrë që ata të përqendrohen tek prodhimi. Operatorët mund të ç'aktivizojnë opsionet e punës për tu bërë më produktivë kur vjen fjala tek kryerja e disa detyrave të tilla si goditja me çekiç, ngarkimi/shkarkimi apo gradimi i hollë. Është i përsosur për kursimin e karburantit gjithashtu, sepse makina ecën më qetë, në mënyrë eficiente dhe efektive.



nisi programin e ri të paraqitjes së produktit për Serinë F të ekskavatorit me rrota. Ai do të jetë Stage IV, EPA Tier IV i përputhshëm dhe i disponueshëm në fillim të vitit 2015.

EKSKAVATORI I 25,000-T ME RROTA ËSHTË PRODHUAR DHE LIVRUAR

Kjo na sjell në fund të Korrikut 2012. Pas më shumë se 20-vjet histori, Caterpillar ka prodhuar ekskavatorin e 25,000-t me rrota, një M318D. Për të festuar këtë arritje, tregtari i Cat Zeppelin i dorëzoi M318D të zbukuruar në mënyrë të veçantë Strabag BMTI gjatë një ceremonie në Mynih, Gjermani. "Biznesi ynë varet nga disponueshmëria e makinave dhe nga sa shpejt nëse lind nevoja mund të jetë në kantierin e ndërtimit një mekanik dhe sa mund të furnizohet pjesa e kërkuar. Kjo nuk është e vërtetë vetëm për Gjermaninë dhe Austrinë, por për të gjithë Evropën.", thotë Werner Baumann, Menaxher në BMTI/Strabag.

"Ai performon mirë në hapësira të ngushta dhe është i përsosur për gradimin e hollë."

Randall Crow, Marketingu i Produktit për Gërmimin në Gjenevë

EVOLUCIONET E EKSKAVATORIT ME RROTA

Gjatë dekadave, ekskavatorët Cat me rrota janë përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme dhe evolucioni i mëtejshëm nuk është përjashtim. "Për Serinë F, një fokus i madh është në përfshirjen e teknologjisë së re për të reduktuar konsumimin e karburantit, veçanërisht nëpërmjet hidraulikëve," thotë Brian. "Për shembull, ne do të zëvendësojmë pompat e fiksuara të marrëseve me pompa zhvendosëse, variable, të kontrolluara në mënyrë elektronike. Në këtë mënyrë, lëvizja e vajit hidraulik rregullohet automatikisht në bazë të kërkesës. Kështu, në qoftë se makina nuk është në punë, dërgohet më pak vaj. Kjo redukton kërkesën për motorin dhe kursen karburantit."

Fokusi më i madh, megjithatë do të jetë në përmirësimin e besueshmërisë. "Gjëja më e rëndësishme për pronarët dhe operatorët është që makinat të punojnë kur nevojitet," thotë Brian. Prandaj, fasiliteti i prodhimit në Grenoble po përjeton një transformim prej 20 milionë dollarë për të ndjekur

parimet e prodhimit të Caterpillar për një makinë konsistente dhe shumë më tepër të besueshme.

PËRGJIGJJA NDAJ TREGJEVE NË NDRYSHIM

Ndërsa shumë nga evolucionet e përfshira në linjën tjetër të ekskavatorëve Cat me rrota janë progresione të natyrshme, disa janë në përgjigje të tregjeve specifike – veçanërisht në Evropë.

"BE është një treg i sofistikuar. Operatorët duan shumë punime hidraulike komplekse, për të përdorur mjete të ndryshme dhe një mjedis të nivelit të lartë për operatorin," thotë Brian. "Kështu, tani ne kemi tre opsione të ndryshme të sediljes dhe monitorët janë 40 për qind më të mëdhenj me rezolucion më të madh. Ekziston SmartBoom, drejtimi me levë dhe kontrollimi i drejtitimit që përdor jastëk ajri për të kundërvepruar ndaj goditjeve kur udhëton në rrugë, plus një listë avancimesh të tjera."

Caterpillar ka qëllimin që të bëhet lider në mbarë botën në ekskavatorët me rrota në vitin 2020. Synimi i kompanisë është në Azi, AME dhe CIS. "CIS, dhe veçanërisht Rusia është oportuniteti më i madh pas Gjermanisë dhe Koresë," shton Brian. Kjo vjen ngaqë Rusia ka një trashëgimi të gjatë të ekskavatorëve me rrota. Sfidat është që të livroheshin makinat që i përshatën një koncepti të ndryshëm të çmimit për propozimin e vlerës. Brian vazhdon të thotë, "Ajo që po bëjmë është përshtatja e projektimit nga një pikëpamje konfiguracione për të ofruar opsione më bazë të makinës në mënyrë që të plotësojmë pikat e çmimit të duhur dhe që makinat të lehta për tu zotëruar dhe operuar."

Në vitin 2014, Caterpillar do të fillojë gjithashtu të prodhojë makina në Kinë për t'i shërbyer tregjeve vazhdimisht në rritje dhe të rëndësishme të tillë si Azia, AME dhe CIS. Duke bërë këtë, do të thotë Caterpillar mund t'i plotësojë kërkesat në rritje të çdo tregu. ■

Werner Baumann,
Drejtor Ekzekutiv i BMTI,
Baumaschinen-technik
International GmbH, Dega
e Grupit Strabag.

"Kemi vetëm një fraksion të 25,000 ekskavatorëve me rrota të prodhuar por jemi të kënaqur me këtë botim përvjetori. Nga 800 makinat tona Cat, shumë prej tyre janë ekskavatorë me rrota."





DËSHIRON TË NDIHMOSH NË DESIGN-IN E LINJËS SË ARDHSHME TË MAKINAVE CAT?

Prej nga vijnë shumë ide për përshtatjen dhe inovacionin e pajisjeve Cat®? Do të befashoheshit. Ato vijnë prej Panelit të Klientëve të Cat dhe prej njerëzve si ju!

Të disponueshme në 8 gjuhë, Paneli i Klientëve të Cat është një grup klientësh, duke përfshirë, pronarë kompanish, operatorë, menaxherë të flotave dhe menaxherë shërbimi. Anëtarët e panelit shprehin opinionet e tyre rreth makinave Cat, në mënyrë ekskluzive për klientët e Cat, për të ndihmuar specialistët e produkteve tona në zhvillimin e zgjidhjeve që synojnë rritjen e kthimit të investimit të klientëve.

Nëpërmjet panelit, rekomandimet dhe reagimet mbledhen për pesë grupe produktesh:

- gradues motorikë
- ngarkues me rrota
- traktor i tipit me zinxhir
- eskavatorët hidraulikë
- eskavator me rrota

Më pas, informacioni analizohet dhe mund të inkorporohet në produktet e ardhshme Cat. Në vijim, ne ndjekim procesin dhe ofrojmë rezultatet për ju. Bëhu pjesë e skuadrës që krijon makinën tuaj të ardhshme Cat. Vizitoni <http://core.mycatvoice.com/join>. ■

LINI
GJURMËT TUAJA
NË
MAKINËN E ARDHSHME
CAT®



~ Bëhuni pjesë e Panelit të Klientëve të Cat

ÇFARË PRITET PREJ NJË PANELISTI?

- Vetëm 1 ose 2 pyetësor në muaj
- Çdo pyetësor plotësohet në një kohë prej 5 deri në 10 minutash

CILAT JANË PËRFITIMET E PANELIT?

- Ndhima që ofrohet për krijimin e brezit të ri të produkteve dhe shërbimeve
- Rritja e rezultateve dhe e suksesit tuaj
- Dëgjohuni prej Skuadrës së Caterpillar®



PAJISJE QË JU MUND TË BESONI

Të Përdorura- Çertifikuara Cat®



Të inspektuara, të garantuara dhe të gatshme për punë

- Një garanci prej Caterpillar®
- Një makinë që i përmbahet standardeve të Caterpillar
- Një makinë plotësisht e inspektuar dhe e ofruar
- Një makinë e rinovuar me pjesë të Cat®

©2012 Caterpillar Inc. Të gjithë të drejtat të rezervuara. CAT, CATERPILLAR, logot e tyre respektive, «Caterpillar Yellow» dhe një pamje tregtimi POWER EDGE, si edhe identitetin e korporatës dhe të produktit të përdorur këtu, janë marka tregtare dhe nuk mund të përdoren pa leje.

Teknoxgroup





©2011 Caterpillar, All Rights Reserved. CAT, CATERPILLAR, their respective logos, "Caterpillar Yellow" and the POWER EDGE trade dress, as well as corporate and product identity used herein, are trademarks of Caterpillar and may not be used without permission.

www.teknoxgroup.com

TEKNOXGROUP SHQIPERI SH.P.K.
Fshati Mucaj - Vore - Albania
Tel: +355 44504747
Fax: +355 44504750

